



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"



Rruga e Shkronjave nr.1 20 000 Prizren-Kosovë ;Tel :+381 (0) 29 232 140 ; Homepahe :www.uni-prizren.com

nr. ref. _____ Prizren, më : 21/05/2021

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i formuar sipas vendimit të KD-së nr. 01-152 të datës 11.05.2021, bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621, Rregulloren për zgjedhjet e studentëve nr. 01-34 të datës 09.02.2018, vendimin për plotësim ndryshimin e kësaj rregullore nr. 01-150 të datës 11.05.2021 si dhe në respektim të dinamikës së zgjedhjeve të miratuara nga Këshilli Drejtues me nr. 01-153 të datës 11.05.2021:

miraton:

Qarkoren administrative të mbarëvajtjes së procesit të zgjedhjeve studentore për vitin 2021

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i formuar sipas vendimit të KD-së, nr. 01-152, menjëherë pas konstituimit obligohet sipas detyrës zyrtare për publikimin me kohë të të gjitha vendimeve dhe njoftimeve përkatëse në lidhje me zgjedhjet e studenteve.

Faza përgatitore parazgjedhje

I

2. Takimi i parë i KQZ-së në prezencë të Kryesuesit dhe zyrtarit ligjor të KD-së, është realizuar më 12.05.2021.
3. Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendës-kryesuesit. Kryesuesi i KQZ-së, anëtarë ex-officio sipas nenin 12 të rregullores është Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit, si dhe zëvendës-kryesuesi i KQZ-së zgjedhet përfaqësuesi i Organizatës studentore AS (Alternativa Studentore).
4. KQZ bazuar në dispozitat e rregullores nr. 01-34 cakton edhe personelin teknik – mbështetës në procesin e zgjedhjeve për kryerjen e punëve të Sekretarisë së KQZ-së, procesin e përgatitjes së fletëvotimeve dhe listave të studentëve me të drejtë vote si dhe punë tjetra deri në ditën e certifikimit të rezultatit zgjedhor. KQZ merr vendim të veçantë për caktimin e stafit teknik - mbështetës për këtë proces.
5. KQZ përmes kryesuesit të KQZ-së kujdeset për zbatimin e dinamikës së zgjedhjeve dhe organizimin e takimeve, procesin e regjistrimit të organizatave studentore dhe respektimin e afateve deri në fazën e dytë që është Certifikimi i Organizatave Studentore.

II

6. Në ditën e parë pas kalimit të afatit të fundit të aplikimit të organizatave studentore, Kryesuesi i KQZ-së, fton takimin e dytë të KQZ-së,(20.05.2021) me këtë rend dite:
 - Vlerësimi i procesit të zgjedhjeve deri në këtë fazë.
 - Aprovimi i Qarkores Administrative në përputhje me dinamikën e zgjedhjeve.
 - Certifikimi i Organizatave Studentore.
 - Llogaritjen e kostos buxhetore të procesit të zgjedhjeve dhe hartimi i kërkesës për KD në lidhje me ndarjen buxhetore.
 - Të tjera.

III

7. Takimi i tretë i KQZ-së organizohet me datën 21.05.2021 me këtë rend dite:

- Vlerësimi i procesit të zgjedhjeve deri në këtë fazë.
- Nxjerrja e vendimit për formën e organizimit të zgjedhjeve përkatësisht procesit të votimit (votim përmes sistemit –elektronik ose votim përmes fletëvotimeve fizike).
- Formimi i komisioneve zgjedhore të njëjësive akademike (Sekretari i Njësisë Akademike, dy anëtar nga personeli administrativ dhe nga një përfaqësues i dy organizatave më të mëdha studentore) dhe stafit teknik mbështetës të KQZ-së.
- Tërheqja e shortit.
- Të tjera.

IV

8. Takimi i katërt i KQZ-së organizohet me datën 24.05.2021 me këtë rend dite:

- Vlerësimi i procesit të zgjedhjeve deri në këtë fazë.
- Verifikimi, miratimi dhe shpallja e listës preliminare të studentëve me të drejtë vote.
- Nxjerrja e njoftimit për afatin e ankesave në lidhje me listën preliminare.
- Të tjera.

V

9. Takimi i pestë i KQZ-së organizohet me datën 31.05.2021 me këtë rend dite:

- Vlerësimi i procesit paraprak.
- Takimi i KQZ-së me komisionet zgjedhore të fakulteteve (KZF-të)
- Certifikimi i listave të kandidatëve për Parlament të studentëve dhe Këshill të Studentëve.
- Propozimi i formatit të fletëvotimeve dhe materialit tjetër zgjedhor, procesverbalit dhe udhëzuesve për zgjedhje.
- Të tjera.

VI

10. Takimi i gjashtë i KQZ-së organizohet me datën 02.06.2021 me këtë rend dite:

- Vlerësimi i procesit paraprak.
- Shqyrtimi i ankesave në lidhje me listën paraprake dhe shpallja e listës përfundimtare të studentëve me të drejtë vote
- Aprovimi i formatit të fletëvotimeve dhe materialit tjetër zgjedhor, procesverbalit dhe udhëzuesve për zgjedhje.
- Të tjera.

Periudha e votimit (zgjedhjeve)

11. Data e mbajtjes së zgjedhjeve është 09.06.2021, ditë e mërkurë.

12. Pranim-dorëzimi i materialeve ditën e votimit nga ora 07- 45 deri më 8:00

13. Anëtarët e KQZ-së dhe KFZ-ve duhet të jenë prezent para hapjes së vendvotimeve.

14. Vendvotimet hapen në ora 8:00 dhe mbyllen ora 19:00.

15. Dorëzimi i kutive të votimit ora 19:00. Pranim-dorëzimi i materialit zgjedhor nga kryesuesi i KZF në KQZ.

16. Shpallja e rezultateve preliminare më 10.06.2021 dhe njoftimi për të afatin e ankesës në KQZ (brenda 72 orëve pasi të jenë shpallur rezultatet preliminare).
17. Shpallja e rezultateve përfundimtare 17.06.2021 dhe njoftimi për të afatin e ankesës në shkallën e dytë, respektivisht në Këshillin Drejtues të Universitetit "Ukshin Hoti" (brenda 2 javëve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare).

18. Certifikimi i zgjedhjeve nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren

Data: 24.05.2021

- Burim Berisha Kryesues i KQZ-së
- Arianit Berisha zëvendëskryesues
- Nysret Bytyqi anëtar
- Xhafer Elshani anëtar

Berisha
Berisha
Bytyqi

